



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:074740
Datë: 28.06.2024
Numri i dokumentit: 05874901

KPPP.nr.1522/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “Dorofix” SHPK, me NUI:811168146, me seli në fsh. Stankoc, komuna e Drenasit, me përfaqësues J.P., kundër debitorit “NAKI-TRADE” SHPK, me NUI:810835879, me seli në Prishtinë, rr. “Agim Ramadani” duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori kundër Urdhrit P.nr.26/22 të datës 17.03.2022, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Fatos Shatri me seli të zyrës në Pejë, jashtë seancës, me datë 27.06.2024, mori këtë:

AKTVENDIM

I.REFUZHET si i pabazuar prapësimi i debitorit “NAKI-TRADE” SHPK, ashtu që Urdhri P.nr.26/22 i datës 17.03.2022, i lëshuar nga Përmbaruesi Privat Fatos Shatri MBETET NË FUQI në tërësi.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar Urdhrit P.nr.26/22 të datës 17.03.2022, me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumenteve të besueshme – faturave dhe atë: faturës nr.210/21 e datës 15.07.2021 dhe faturës nr.222/21 e datës 24.07.2021, faturës nr.227/21 e datës 27.07.2021, faturës nr.231/21 e datës 30.07.2021, faturës nr.254/21 e datës 13.08.2021, faturës nr.273/21 e datës 27.08.2021, faturës nr.298/21 e datës 18.09.2021,

faturës nr.301/21 e datës 21.09.2021, faturës nr.310/21 e datës 27.09.2021, faturës nr.323/21 e datës 06.10.2021, faturës nr.336/21 e datës 12.10.2021, faturës nr.384/21 e datës 15.11.2021, faturës nr.397/21 e datës 23.11.2021, faturës nr.400/21 e datës 24.11.2021, faturës nr.406/21 e datës 26.11.2021 dhe faturës nr.426/21 e datës 06.12.2021 duke urdhëruar debitorin që menjëherë pas pranimit të urdhrit, t'ia paguajë kreditorit borxhin 15,554.85 Euro, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore sipas tarifës së përmbartuesve, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm.

Kundër urdhrit të Përmbartuesit Privat, brenda afatit të rregullt ligjor debitori ka ushtruar prapësim, me arsyetimin se kreditori dhe debitori kanë lidhur marrëveshje për furnizim me material ndërtimi dhe për çështjen e pagesës janë dakorduar se do të faturohet dhe në bazë të saj do të bëhet pagesa, por në mungesë të mjeteve financiare do të ketë tolerime. Tutje debitori ka shtuar se faturat e bashkangjitura me urdhrin përmbartimor janë në pajtim me dispozitat e nenit 29 të LPP, por të cilat nuk i janë prezantuar debitorit drejtpërdrejtë por të punësuarve si kryes të punëve të cilët nuk e kanë njoftuar direkt debitorin, po ashtu as nga kreditori nuk ka pas vërejtje se tani për tani duhet paguar shumat e faturave. Debitori i ka propozuar gjykatës që të aprovoj në tërësi si të bazuar Prapësimin e debitorit dhe të shfuqizoj në tërësi Urdhrin Përmbartimor P.nr.26/22.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka theksuar se i kundërshton në tërësi pretendimet e debitorit, kreditori thekson se me debitorin ka lidhur marrëveshje e cila e obligon blerësin (në këtë rast debitorin) që porosinë ta bëj 48 orë më herët, të verifikoj sasinë në prezencën e përfaqësuesit të kreditorit dhe të nënshkruaj fletëdërgesën ose faturën, furnizimi bëhet gjatë muajit, ndërsa pagesa bëhet deri më datë 5 të muajit të ardhshëm, për muajin paraprak. Në bisedime me debitorin, ai ka kërkuar data të caktuara për kryerjen e pagesave në mënyrë që t'i përmbahet obligimit financiar, provë shtesë është komunikimi përmes emailit me debitorin.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit, deklarimeve në përgjigje në prapësim të kreditorit dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe duhet të refuzohet në tërësi për arsyet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërkaq me paragrafin 3 të po të

njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbardim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Tutje me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbardim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbardimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në shkresat e lëndës është evidentuar se kreditori i ka bashkëngjitur propozimit për përmbardim dokumentet e besueshme: faturës nr.210/21 e datës 15.07.2021 dhe faturës nr.222/21 e datës 24.07.2021, faturës nr.227/21 e datës 27.07.2021, faturës nr.231/21 e datës 30.07.2021, faturës nr.254/21 e datës 13.08.2021, faturës nr.273/21 e datës 27.08.2021, faturës nr.298/21 e datës 18.09.2021, faturës nr.301/21 e datës 21.09.2021, faturës nr.310/21 e datës 27.09.2021, faturës nr.323/21 e datës 06.10.2021, faturës nr.336/21 e datës 12.10.2021, faturës nr.384/21 e datës 15.11.2021, faturës nr.397/21 e datës 23.11.2021, faturës nr.400/21 e datës 24.11.2021, faturës nr.406/21 e datës 26.11.2021 dhe faturës nr.426/21 e datës 06.12.2021, në origjinal dhe me të gjitha elementet përmbajtësore të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së për zbatimin e përmbardimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, të njëjtat janë dorëzuar në origjinal dhe janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, fakt i cili vërtetohet nga vula e pranimit të debitorit në këto fatura.

Andaj, bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbardimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së.

Nga sa u theksua më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij

aktvendimi, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit gjykata ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1522/23, me datë 27.06.2024

Gj y q t a r i,
Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomën e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.